

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
“ALBA SYSTEM TECHNOLOGY” SHPK

KREU I
Pjesa e përgjithshme

Ky statut, akti i themelimit dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë marrëdhëniet midis ortakëve të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY” SHPK.

KREU II
Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i
Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e
Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakëve

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY”.
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Rruga e Curilave, ZK 8512, nr. pasurie 29/166+2-N10, Durrës.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe

STATUTO
DELLA
SOCIETÀ COMMERCIALE A
RESPONSABILITÀ LIMITATA
“ALBA SYSTEM TECHNOLOGY” SRL

CAPITOLO I
Parte generale

Il presente statuto, atto costitutivo e la Legge del 14.04.2008, nr. 9901, “Per gli Imprenditori e le Imprese Commerciali”, regolano i rapporti fra i soci della società commerciale a responsabilità limitata “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY” SRL.

CAPITOLO II
Denominazione, Forma, Sede Centrale, Oggetto
dell’Attività, Durata, Filiali e Uffici di
Rappresentanza, Responsabilità dei Soci

ARTICOLO 1
Denominazione

La società commerciale a responsabilità limitata è denominata “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY”.
Il cambio della denominazione della società può avvenire solo dietro una decisione dell’Assemblea Generale della società.

ARTICOLO 2
Forma

La società commerciale “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY”, ha la forma di una società a responsabilità limitata.


ARTICOLO 3
Sede Centrale

3.1 La società commerciale a responsabilità limitata “ALBA SYSTEM TECHNOLOGY” SRL, avrà la sua sede centrale in Albania, Rruga e Curilave, ZK 8512, nr. pasurie 29/166+2-N10, Durazzo.

3.2 Il cambio della sede centrale della società può avvenire solo dietro la decisione dell’Assemblea Generale della società.

ARTICOLO 4
Oggetto dell’attività

La società ha per oggetto in Albania e all'estero:



jashtë:

- Zhvillim, prodhim, marketing apo shërbime inovative me zhvillim të lartë teknologjik, sistemet për telemetrinë dhe kontrollat teknologjike, networking (rrjetëzimin), realizimin, dhënien me qira dhe mirëmbajtjen e sistemeve telefonike, alarmet e sigurisë, sistemet e parandalimit të zjarrit, video survejimi, sistemet audio, sistemet elektrike, sistemet e kondicionimit termik, automatizimi industrial, sisteme automatike identifikimi për mjedisin dhe ekologjinë, identifikimi me teknologjinë RFID, pajisje elektro-mjekësore;

- Zhvillimi dhe dizajni i software dhe hardware në lidhje me aktivitetet e lartpërmendura, dhe jo vetëm;

- Konceptimi, projektimi, ofrimi dhe marketingu i kurseve të arsimimit dhe trajnimit; Trajnimi i personelit mësimor dhe konsulenca arsimore për vlerësimin e gjendjes së profesionalizmit të pranishëm dhe pas arsimimit dhe trajnimit të zhvilluar;

- Tregtimi me shumicë dhe në minutë të produkteve të natyrës tekstile dhe teknike.

- Shoqëria, për arritjen e qëllimit të korporatës, mundet, për më tepër, të kryejë të gjitha transaksionet financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të marrë pjesë në aksione dhe interesa në shoqëri ose ndërmarje të tjera, të themeluara ose që përbëjnë, që kanë një objekt analog ose të ngjashëm, të paraqesi garanci reale dhe personale edhe në favor të të tretëve;

- Shoqëria mund të marrë pjesë në prokurimin publik.

- Ndërtimi, blerja, shitja, qiraja, dhënia me qira, ruajtje, riparim, mirëmbajtje, përgatitjen e çdo anije dhe mjeti argëtues për çdo rast dhe çdo lloj përdorimi; rikuperimi i varkave të çdo lloji me vela dhe motor dhe asistencë teknike përkatëse në tokë, në port dhe në det, rikuperimi i të gjitha anijeve të fundosura ose të dëmtuara për të ruajtur sigurinë në det, punime nënujore të çdo lloji, përfaqësim dhe tregtim motorrash me pakicë dhe shumicë, aksesore, instrumente lundrimi, esenca druri për përgatitjen e çdo lloj mjeti lundrues, dhe çdo produkt tjetër që lidhet me pajisjen e lundrimit me varkë, produkte higjienike, praktikat e certifikimit dhe trajnimet specifike për sektorin detar, sigurimet e çdo dege.

NENI 5 ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pa caktuar.

- Sviluppo, Produzione, commercializzazione o servizi innovativi ad alto sviluppo tecnologico, impianti per telemetrie e controlli tecnologici, networking, realizzazione, noleggio e manutenzione impianti telefonici, antifurto, antincendio, videosorveglianza, impianti audio, impianti elettrici, termici di condizionamento, automazione industriale, sistemi di identificazione automatica per l'ambiente e l'ecologia, identificazione con tecnologia RFID, apparecchiature elettromedicali;

- Sviluppo e progettazione di software e hardware, relativi alle attività predette, e non solo;

- L'ideazione, la progettazione, l'erogazione e la commercializzazione di corsi di formazione e di addestramento; la docenza nella formazione e nell'addestramento del personale la consulenza per la valutazione dello stato di professionalità presente e successivo alla formazione ed all'addestramento sviluppato.

- Il commercio all'ingrosso ed al minuto di prodotti di natura tessile anche tecnica.

- La società, per il conseguimento dell'oggetto sociale, potrà, inoltre, compiere tutte le operazioni finanziarie, mobiliari ed immobiliari, assumere partecipazioni ed interessenze in altre società od imprese, costituite o costituende, aventi oggetto analogo od affine, presentare garanzie reali e personali anche a favore di terzi;

- La società può partecipare agli appalti pubblici.

- La costruzione, l'acquisto, la vendita, il noleggio, la locazione, rimessaggio, la riparazione, la manutenzione, l'allestimento a qualsiasi imbarcazione e nave da diporto e comunque di ogni tipo di uso adibito; il ricovero di natanti di qualsiasi genere a vela e a motore e la relativa assistenza tecnica a terra, in banchina e in mare, recupero traino di tutti i natanti in affondamento o in avaria nel salvaguardare la sicurezza a mare, lavori subacquei di qualsiasi genere, la rappresentanza ed il commercio al minuto e all'ingrosso di motori, accessori, strumenti di navigazione, essenze legnose per l'allestimento di ogni tipo di natante, e ogni altro prodotto inerente all'allestimento della nautica, prodotti per l'igiene, pratiche certificazione e formazioni specifiche per il settore nautico, assicurazione di ogni ramo.

ARTICOLO 5 ***Durata***

La società svolgerà la propria attività a tempo indeterminato.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "ALBA SYSTEM TECHNOLOGY" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "ALBA SYSTEM TECHNOLOGY" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

KREU III

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALBA SYSTEM TECHNOLOGY" SHPK është 1,000 (një mijë) Euro, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku.

8.2 Ortaku **Z. Mauro Montanari** zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 1,000 (një mijë) Euro, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind përqind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga

ARTICOLO 6

Filiali e Uffici di Rappresentanza

La società commerciale "ALBA SYSTEM TECHNOLOGY" SRL può attivare delle sue filiali o degli uffici di rappresentanza entro il territorio nazionale o all'estero.

ARTICOLO 7

Responsabilità dei Soci

I soci non rispondono degli obblighi della società "ALBA SYSTEM TECHNOLOGY" SRL e rispondono personalmente delle perdite della società fino alla parte non conferita dei contributi dagli stessi sottoscritti.

CAPITOLO III

Capitale Registrato e Partecipazioni, Aumento e Riduzione del Capitale, Cessione delle Quote di Capitale

ARTICOLO 8

Capitale Registrato e Partecipazioni

8.1 Il capitale registrato della società a responsabilità limitata "ALBA SYSTEM TECHNOLOGY" SRL è di Euro 1,000 (mille), ed è regolarmente sottoscritto e versato dal socio.

8.2 Il socio **Sig. Mauro Montanari** possiede 1 (una) quota di capitale dal valore di Euro 1,000 (mille), che rappresenta una partecipazione al 100 % (cento per cento) sul capitale sociale.

ARTICOLO 9

Aumento del Capitale Registrato

9.1 Il capitale registrato della società può aumentare senza alcun limite, una o più volte, con decisione dell'Assemblea Generale.

9.2 In caso di aumento di capitale registrato della società, tutti i soci hanno il diritto di sottoscrivere e pagare le parti del capitale aumentato in proporzione alla propria partecipazione nel capitale.

ARTICOLO 10

Riduzione del Capitale Registrato

10.1 La società può ridurre il capitale registrato con decisione dell'Assemblea Generale. In ogni caso, il capitale registrato della società non può essere ridotto sotto il minimo previsto dalla legge.

ligji.

10.2 Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosi ndryshe.

NENI 11

Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

11.1 Kuotat e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve, ortakë ose jo ortakë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me kushtëzimet e mëposhtme:

- Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshirojnë të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë.

Ortaku që dëshirojnë të shesë kuotën e tij ia ofron atë ortakëve të tjerë nëpërmjet administratorit. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, ortakët e tjerë duhet të përgjigjen për ushtrimin e të drejtës së parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej saj. Në rast se ortakët që do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes janë më shumë se një, kuota ndahet ndërmjet tyre në pjesë të barabarta.

- Në rast se ortakët nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshirojnë të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë atëherë kjo e drejtë mund të ushtrohet nga vetë shoqëria.

Ortaku që dëshirojnë të shesë kuotën e tij ia ofron atë shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, shoqëria duhet të ushtrojë të drejtën e parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ajo ka hequr dorë prej saj.

Në rast se shoqëria vendos ta ushtrojë të drejtën e parablerjes ajo duhet të autorizojë administratorin për të blerë kuotën dhe të vendosë anulimin e saj. Në këtë rast, shoqëria duhet të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vlerën nominale të kuotës së anuluar. Si pasojë e këtij zvogëlimi të kapitalit do të ndryshojë edhe raporti i pjesëmarrjes në kapital të ortakëve të shoqërisë.

- Në rast se ortaku që tjetërson kuotën e vet, ia shet atë një të treti jashtë shoqërisë, me çmim dhe kushte më të favorshme nga ato që ua ka ofruar ortakëve dhe shoqërisë për efekt të ushtrimit të së

10.2 La riduzione del capitale interessa i soci in proporzione alla loro partecipazione nel capitale, tranne quando, ai sensi della legge o dello statuto, l'Assemblea Generale può decidere diversamente.

ARTICOLO 11

Cessione delle Quote del Capitale Registrato

11.1 Le quote del capitale possono essere cedute, interamente o parzialmente, ai terzi, soci o non soci della società, ma in osservanza delle seguenti clausole:

- I soci godono del diritto di prelazione per la quota che intende cedere uno dei soci della società.

Il socio che intende cedere la propria quota la offre agli altri soci tramite l'amministratore.

Gli altri soci hanno il diritto di prelazione della quota alle stesse condizioni e allo stesso prezzo in cui il socio potrebbe cedere tale quota ad un terzo, non socio.

Entro 10 (dieci) giorni dalla presentazione dell'offerta, gli altri soci devono rispondere in merito all'esercizio del diritto di prelazione o, in caso contrario, si riterrà che gli stessi ne hanno rinunciato. Qualora i soci che eserciteranno il diritto di prelazione sono più di uno, la quota è divisa fra di loro in parti uguali.

- Qualora i soci non esercitino il diritto di prelazione per la quota che intende cedere uno dei soci, allora tale diritto può essere esercitato dalla stessa società.

Il socio che intende cedere la sua quota, la offre alla società.

La società gode del diritto di prelazione della quota alle stesse condizioni ed allo stesso prezzo con cui il socio potrebbe cedere tale quota ad un terzo, non socio.

Entro 10 (dieci) giorni dalla data di presentazione dell'offerta, la società deve esercitare il diritto di prelazione o, in caso contrario, si riterrà che la stessa ne abbia rinunciato.

Qualora la società decida di esercitare il diritto di prelazione, essa deve autorizzare l'amministratore ad acquistare la quota e decidere la sua revoca. In tal caso, la società deve ridurre il capitale registrato con il valore nominale della quota revocata. In conseguenza di tale riduzione di capitale si modificherà anche il rapporto di partecipazione dei soci nel capitale sociale.

- Qualora il socio che altera la propria quota, la cede ad un terzo estraneo alla società, ad un prezzo e condizioni più favorevoli di quelli offerti ai soci, agli effetti dell'esercizio del diritto

drejtës së parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata e shitjes që ortaku do të lidhë me personin e tretë do të jetë e pavlefshme dhe shoqëria nuk do të japë miratimin për këtë kalim.

11.2 Të gjitha njoftimet në funksion të zbatimit të këtij neni do të bëhen me shkrim me letër të porositur (rekomandë).

11.3 Parashikimet e këtij neni do të aplikohen në rast se shoqëria do të ketë më shumë se një ortak.

KREU IV ***Organet e Shoqërisë***

NENI 12 ***Asambleja e Përgjithshme***

Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

NENI 13 ***Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme***

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- anulimin e kuotave;
- largimin ose përjashtimin e ortakut;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo nga ky statut.

di prelazione da parte loro, il contratto di cessione che il socio andrà a stipulare con la persona terza sarà non valido e la società non darà il proprio consenso per tale passaggio.

11.2 Tutte le comunicazioni in funzione dell'osservanza del presente articolo, saranno effettuate per iscritto e per posta raccomandata (A/R).

11.3 Le previsioni del questo articolo saranno applicate nel caso in cui la società avrà più di un socio.

CAPITOLO IV ***Organi sociali***

ARTICOLO 12 ***Assemblea Generale***

L'organo deliberativo della società è l'Assemblea Generale.

ARTICOLO 13 ***Diritti e Doveri dell'Assemblea Generale***

L'Assemblea Generale è responsabile delle decisioni adottate per la società in merito a:

- la definizione delle politiche commerciali della società;
- le modifiche dello statuto;
- la nomina e la revoca degli amministratori;
- la nomina e la revoca dei liquidatori e degli esperti contabili autorizzati;
- la definizione dei compensi per gli amministratori, i liquidatori e gli esperti contabili autorizzati;
- la vigilanza sull'attuazione delle politiche commerciali da parte degli amministratori, ivi inclusa l'elaborazione delle analisi finanziarie annue e dei rapporti sull'andamento dell'attività;
- l'approvazione delle analisi finanziarie annue e dei rapporti sull'andamento dell'attività;
- l'aumento e riduzione del capitale;
- la divisione e la revoca delle quote;
- la rappresentanza della società alle liti ed in altri procedimenti verso gli amministratori;
- la riorganizzazione e lo scioglimento della società;
- l'approvazione delle norme procedurali delle adunanze dell'assemblea;
- la destinazione degli utili annui e copertura delle perdite;
- la revoca delle quote;
- l'allontanamento o l'esclusione del socio;
- altre questioni previste dalla legge o dallo statuto.

NENI 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Parashikimet e neneve 14 – 16 të këtij statuti do të aplikohen në rast se shoqëria do të ketë më shumë se një ortak.

14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

14.3 Asambleja e Përgjithshme thirret në respektim të parashikimeve të ligjit Nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

14.4 Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të një letre të porositur (rekomande) ose postës elektronike; Ortakët janë të detyruar që të depozitojnë me shkrim pranë administratorit të shoqërisë adresën në të cilën do t'i dërgohet njoftimi nga shoqëria me anë të letrës së porositur (rekomande), si dhe adresën e postës elektronike ku do t'i dërgohet njoftimi me anë të postës elektronike. Dërgimi i njoftimit në këto adresa do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht.

14.5 Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

14.6 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në zyrën qendrore (selinë) të shoqërisë ose në një vend tjetër të propozuar nga administratori dhe të miratuar nga ortakët. Miratimi në këtë rast do të jepet nga ortakët nëpërmjet postës elektronike. Për zhvillimin e mbledhjes në një vend tjetër jashtë selisë së shoqërisë, duhet të jenë pro ortakët të cilët përfaqësojnë 51% të kapitalit të shoqërisë. Në rast se ortakët nuk bien dakord për zhvillimin e mbledhjes në një vend tjetër, atëherë mbledhja do të mbahet në selinë e shoqërisë.

NENI 15

Pjesëmarrja në Vendime

15.1 Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjesëtim me kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.

15.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme nga një ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

15.3 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme nga Administratori.

ARTICOLO 14

Adunanza dell'Assemblea Generale

14.1 L'Assemblea Generale si riunisce nelle ipotesi previste dalla legge e dal presente statuto, ogni qualvolta sia necessario per tutelare gli interessi della società. Le previsioni degli articoli 14 – 16 saranno applicate nel caso in cui la società avrà più di un socio.

14.2 L'Assemblea Generale viene convocata almeno una volta all'anno.

14.3 L'Assemblea Generale viene convocata in osservanza delle previsioni della Legge del 14.01.2008, Nr.9901, "Per gli Imprenditori e le Imprese Commerciali".

14.4 I soci saranno avvisati dell'adunanza dell'Assemblea Generale a mezzo di una lettera raccomandata o la posta elettronica. I soci sono tenuti a depositare, per iscritto, presso l'amministratore della società, l'indirizzo in cui sarà inoltrato l'avviso da parte della società tramite la posta raccomandata, nonché l'indirizzo di posta elettronica in cui sarà inoltrato l'avviso tramite posta elettronica. L'invio dell'avviso di convocazione a questi indirizzi sarà considerato un avviso regolarmente adempiuto.

14.5 L'avviso di convocazione deve contenere il luogo, la data, l'ora dell'adunanza e l'ordine del giorno.

14.6 La riunione dell'Assemblea Generale potrà essere tenuta presso l'ufficio principale (sede) della società o in un altro luogo, anche all'estero, proposto dagli amministratori ed approvato dai soci. L'approvazione in questo caso sarà comunicata dai soci attraverso la posta elettronica. Per lo svolgimento della riunione in un luogo diverso da quello della sede della società, devono esprimere parere positivo i soci che rappresentano il 51% del capitale sociale. In caso di mancato accordo per lo svolgimento della riunione in un luogo diverso, quest'ultima sarà tenuta presso la sede della società.

ARTICOLO 15

Partecipazione alla deliberazione

15.1 Ogni socio ha il diritto al voto in proporzione al suo contributo nel capitale sociale.

15.2 Ogni socio può essere rappresentato all'Assemblea Generale da un socio o da una persona terza, in base ad una delega. Tale delega può essere rilasciata per una sola adunanza dell'Assemblea Generale, e vi rientrano anche le adunanze successive aventi lo stesso ordine del giorno.

15.3 Il socio non può essere rappresentato all'Assemblea Generale dall'Amministratore.

NENI 16
Kuorumi

16.1 Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme në çdo rast janë të vlefshme nëse të marrin pjesë personalisht ose të përfaqësuar, ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave në asamble.

16.2 Për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me 51% të votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

16.3 Për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të cilësuar, si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, anulimi i kuotës së kapitalit, largimi i ortakut, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me $\frac{2}{3}$ e votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

16.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 16.1, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 17
Procesverbal i Mbledhjes

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.

Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverbalit, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit. Procesverbali i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 18
Administratori

18.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

18.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

18.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.

ARTICOLO 16
Il quorum

16.1 Le riunioni dell'Assemblea generale in ogni caso sono valide se ivi partecipano personalmente o tramite procura, i soci che possiedono più della metà del numero totale dei voti dell'assemblea.

16.2 Per le delibere che richiedono la maggioranza ordinaria, l'Assemblea Generale delibera validamente con il 51% dei voti a favore dei soci partecipanti alla riunione.

16.3 Per le delibere che richiedono una maggioranza qualificata, quali modifiche allo statuto, aumento o riduzione del capitale iscritto, distribuzione dei dividendi, riorganizzazione o scioglimento della società, annullamento della quota di capitale, esclusione dei socio, l'Assemblea Generale delibera validamente con i $\frac{3}{4}$ dei voti favorevoli dei soci partecipanti alla riunione.

16.4 Qualora l'Assemblea Generale non potesse essere convocata per mancato raggiungimento del quorum di cui all'Art. 16.1, potrà essere prevista una seconda convocazione da tenersi non più tardi di 30 giorni, avente lo stesso ordine del giorno.

ARTICOLO 17
Verbale dell'adunanza

Tutte le decisioni dell'Assemblea Generale vanno registrate nel verbale. Il verbale indica la data, il luogo dell'adunanza, l'ordine del giorno, il nome del Presidente dell'Adunanza, il nome del Segretario addetto al verbale, i risultati della votazione.

Il Presidente dell'adunanza assegna, per la stesura del verbale, un Segretario il quale potrebbe non essere socio. Il verbale dell'adunanza viene sottoscritto dal Presidente dell'adunanza e dal Segretario.

Si allega al verbale la lista dei presenti e l'avviso di convocazione dell'Assemblea Generale.

ARTICOLO 18
Amministratore

18.1 L'Amministratore è l'organo esecutivo della società.

18.2 La società è amministrata da un amministratore nominato e revocato dall'Assemblea Generale.

La durata di tale nomina è di 5 anni, con diritto di rinnovo.

18.3 L'amministratore ha diritto di provvedere all'amministrazione ordinaria e straordinaria della società.

18.4 Administratori kryen detyrën e tij në përputhje me të gjitha tagrat e dhënë nga ligji.

18.5 Administratori i parë shoqërisë është **z. Mauro Montanari**.

KREU V

Eksperti Kontabël, Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve

NENI 19

Eksperti kontabël

Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar nga Shoqëria.

NENI 20

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

NENI 21

Shpërndarja e Fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të njafueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU VI

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë, Largimi dhe Përfundimi i Ortakëve

NENI 22

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

22.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga

18.4 L'amministratore svolge il suo dovere in conformità con tutti i diritti previsti dalla legge

18.5 Il primo Amministratore della società è il **Sig. Mauro Montanari**.

CAPITOLO V

Esperto Contabile, Anno Finanziario e Bilancio Annuo, Destinazione degli Utili

ARTICOLO 19

Esperto contabile

Il controllo del bilancio finanziario e dei libri contabili della Società saranno, se necessario o richiesto dalla legge, affidati ad un esperto contabile autorizzato, nominato dalla Società.

ARTICOLO 20

Anno Finanziario e Bilancio Annuo

L'anno finanziario inizia il 1° Gennaio e termina il 31 Dicembre.

Il bilancio annuo, l'inventario, il rapporto sull'andamento dell'attività e il rapporto dell'esperto contabile autorizzato, sono approvati dall'Assemblea Generale.

Gli atti relativi all'esercizio dell'anno finanziario saranno approvati entro 6 (sei) mesi dalla fine dell'anno finanziario.

ARTICOLO 21

Destinazione degli Utili

I soci hanno il diritto di dividere la parte degli utili dichiarati nelle analisi finanziarie della società.

L'utile viene destinato ai soci in rapporto alle quote possedute.

La società può destinare utili ai soci solo se dopo il pagamento dei dividendi risulti che:

- gli attivi della società coprono interamente i suoi obblighi;
- la società dispone di attivi liquidi sufficienti per sostenere gli obblighi che si rendono eseguibili entro i 12 mesi successivi.

CAPITOLO VI

Riorganizzazione della Società, Scioglimento e Liquidazione della Società, Allontanamento ed Esclusione dei Soci

ARTICOLO 22

Scioglimento e Liquidazione della Società

22.1 La società viene sciolta nei casi previsti dalla

Tigji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

22.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

KREU VII
Dispozita të Fundit

NENI 23

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

NENI 24

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane. Akti në gjuhën italiane është përkthyer nga Z. Fjorind Nakolli, njohës i gjuhës italiane dhe person i besuar i ortakut.

ORTAKU THEMELUES

Z. MAURO MONTANARI

MONTANARI MAURO



legge o con una decisione dell'Assemblea Generale.
In caso di scioglimento la società sarà soggetta alla procedura di liquidazione.

22.2 Per la procedura di liquidazione della Società sarà applicata la normative Albanese vigente.

CAPITOLO VII
Ultime Disposizioni

ARTICOLO 23

Tutti gli eventuali disaccordi che potrebbero sorgere fra i soci vanno risolti bonariamente. Nei casi in cui non possono essere risolti bonariamente, ognuno dei soci ha il diritto di ricorrere per una soluzione al Tribunale del Distretto Giudiziario competente.

ARTICOLO 24

Per quanto non previsto nel presente Statuto trova applicazione la Legge del 14.04.2008, nr.9901, "Per gli Imprenditori e le Imprese Commerciali", nonché la normativa albanese in vigore.

Il presente statuto viene redatto in 2 (due) copie in originale nella lingua albanese ed italiana. Il documento nella lingua albanese e tradotto dall Sig. Fjorind Nakolli, conoscitore della lingua albanese e persona fidata del socio.

IL SOCIO FONDATORE

Sig. MAURO MONTANARI

MONTANARI MAURO



1 Euro = 121.28 Lek

14.02.2022